



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.07.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "FIDANI -L" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale ", Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " FIDANI -L " SH.P.K., e dt.07.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale ", Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 24.06.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Përmirësohet** pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 24.06.2026;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " FIDANI -L " SH.P.K., me dt.07.07.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale ", Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.07.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Pajisja nr. 14. - Cilinder hidraulike me gjemba që montohet në eskavator ose luge ngarkuese me kapacitet 400 deri 500 kg , pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është pjesërisht i bazuar - korrigjohet dhe bëhet deri në 500 kg nga sa ka qenë (400 deri ne 500 kg);

2. Pajisja nr. 19. – Buldozher rrafshues me peshe totale maximum 5t, pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është i bazuar - korrigohet dhe bëhet deri 14 ton , nga sa ka qenë max. 5 ton;
3. Pajisja nr. 21. – Makine Ngjeshese e dheut me peshe totale maximum 1.4t , pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është i bazuar dhe hiqet nga kriteret;
4. Pajisja nr. 23. – Kontinier montues ne kamion me peshe totale deri ne 2t , pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është i bazuar dhe hiqet nga kriteret;
5. Pajisja nr. 9. – Kamion Automikser për bartjen e betonit të gatshëm , pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është pjesërisht i bazuar, pasi që ky mjet është i nevojshëm duke pasur parasysh natyrën e punës dhe terrenin ku do te kryhet punimet sipas përshkrimit, por zvogëlohet sasia nga 4 copë në 2 copë;
6. Pajisja nr. 29. – Kove qe montohet ne eskavator me sistem hidraulik per perzierjen e betonit 0.25m³ , pretendimi juaj lidhur me këtë pikë është i pa bazuar, pasi që ky mjet është i nevojshëm duke pasur parasysh natyrën e punës dhe terrenin ku do te kryhet punimet sipas përshkrimit, prandaj i njëjti mbetet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit te Komunës;

Te gjitha palëve te interesuara;